



Federata e Futbollit shqiptar në Gjermani
Vereinigung der Albanischen Fussballvereine in Deutschland
Tel.: 0152 22 55 55 88 / 0172 275 17 88 / 0151 11 65 86 39, E-mail: ffdardania@aol.com
IBAN: DE96 5055 0020 0000 0387 76 / SWIFT-BIC: HELADEF1OFF / Sparkasse Offenbach

Frankfurt, 22.02.2022

Federatës së Futbollit të Kosovës
Prishtinë

FFSHGJ përkrah kandidaturën e Agim Ademit për president të FFK-së

Federata e Futbollit Shqiptar në Gjermani (FFSHGJ), si organizata më e madhe shqiptare (jo vetëm sportive) në diasporë, është e interesuar që futbollit i Kosovës të përparojë sa më shpejt, njëherit edhe shfaq kënaqësinë për rezultatet e deritashme që ka arritur FFK-ja si në organizimin e futbollit në Kosovë ashtu edhe në prezantimin e tij në garat e organizuara nga UEFA dhe nga FIFA.

FFSHGJ gjatë të gjitha periudhave të pasluftës pati kontakte dhe bashkëpunim të frytshëm me prijësit e FFK-së, nisur nga Sabri Hashani, pastaj Fadil Vokrrin dhe viteve të fundit nga presidenti Agim Ademi.

Në bazë të këtij bashkëpunimi ekipet fituese të Kupës së Kosovës në Gjermani e diasporë kanë shkuar në Kosovë dhe kanë zhvilluar ndeshjet e supërkupës Kosovë-Diasporë, kurse me angazhimin e presidentit Agim Ademi është arritur që ekipi ynë përfaqësues i Diasporës të bëhet pjesëmarrës i Kupës gjithkombëtare më 28 nëntor, në Vlorë, porse rrethanat e shkaktuara viteve të fundit nga pandemia nuk e lejuan një gjë të tillë.

Është ky vetëm një segment i bashkëpunimit të suksesshëm mes FFK-së dhe FFSHGJ-së dhe në bazë të kësaj FFSHGJ ka krijuar një respekt për njerëzit që deri më tash udhëhoqën me futbollin e Kosovës.

Nëse dikush duhet të thirret në emrin e Vokrrit, këtë i pari mund ta bëjë z. Agim Ademi, i cili edhe sa kishte pozitën e nënkryetarit e përkrahu dhe e ndihmoi Vokrrin që sot Kosova të jetë anëtare e UEFA-s dhe e FIFA-s.

Presidenti Agim Ademi është njeriu që me kompetencë e udhëheq futbollin e Kosovës, me aq kompetencë sa nuk mund të ketë askush tjetër në Kosovë, ngase ai është i inkuadruar në futbollin e Kosovës shumë heret.

FFSHGJ, që vepron në një vend shumë demokratik siç është Gjermania angazhohet që kudo të respektohet vullneti dhe synimet e përbërësve të një organizimi e në këtë rast angazhohet për ruajtjen e strukturave të FFK-së të dala nga dëshira dhe vullneti i klubeve dhe i organizmave tjerë futbollistike të vendit.

Andaj me të drejt i jep një përkrahje të plotë presidentit Agim Ademi, që të zgjidhet edhe për një mandat në krye të FFK-së me çka do të mbroheshin të arriturat shumë të mëdha që u bënë në futbollin e Kosovës e ndër to do të kishim përmendur vetëm disa:

- Përmirësimi shumë i madh i kushteve ku sot luhet futbolla gati në çdo qendër komunale ku ekzistojnë klube të futbollit,
- Futja e sistemit të VAR-it në një afat shumë të shkurtër dhe më shumë sukses,
- Rezultatet shumë të mira të përfaqësueses së Kosovës në garat kualifikuese për kampionate evropiane e botërore,
- Sukseset e klubeve të Kosovës në garat evropiane dhe rritja e numrit të tyre në sezonin që po vjen,
- Stabiliteti financiar dhe zhvillimi i të gjitha veprimtarive në futbollin e Kosovës pa pasur nevojë të ndihmohet nga shteti,
- Dalja në skenën evropiane të gjyqtarëve të futbollit që nga cilësia krahasohen më ata të vendeve ku kjo lojë ka një traditë shumë më të gjatë e rezultate të tjera që në Kosovë sot mund të shihen dhe të preken.

Strukturat e deritashme të FFK-së kanë fituar legjitimitet në Kuvendet zgjedhore dhe se secili prej nesh duhet të respektojë vullnetin e shumicës, nëse dëshirojmë që futbollin e Kosovës ta shohim duke përparuar dhe duke u ngjitur majave të ranglistave evropiane e botërore.

Nisur nga rezultatet e arritura në mandatin e fundit 4-vjeçar, nën udhëheqjen e Z. Agim Ademi, FFSHGJ jep një përkrahje të rezervë punës së deritashme të presidentit Agim Ademi dhe më një dëshirë që ato rezultate të rriten edhe më shumë, përkrah fuqishëm kandidaturën e tij për t'u zgjedhur edhe për një mandat në krye të organizatës së futbollit të Kosovës - FFK-së.

Një zgjedhje e tillë do të gëzonte dashamirët e futbollit të Kosovës kudo që jetojnë ata.



Për Kryesinë e FFSHGJ-së
Ruzhdi Statovci, kryetar